

## STATUTI dhe AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR "ALRWAAD" Sh.P.K KREU 1 DEPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### FORMIMI I SHOQËRISË

#### NENI 1

a. Sot në Tiranë në datën 31/10/2022 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjesi të kufizuara e emertuar "ALRWAAD" Sh.P.K, me vullnetin e lirë të ortakëve, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", formohet shoqëria me përgjigjësi të kufizuar "ALRWAAD" sh.p.k, nga ortakët themelues:

1. **HAMADA HELMY ABDELBADIE ABDELHAMID**, shtetas Egjiptian, I datelindjes 23/07/1987 lindur ne **KALYOBIYA**, madhore me zotesi te plote per te vepruar pa pengesa ligjore , me nr Pasaporte A22972434.

b. Të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinonjë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbje deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria Tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, fiton Personalitetin Juridik nga dita e regjistrimit e saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të biznesit.

#### FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

#### NENI 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjigjësi të Kufizuar.
2. Emërtimi i shoqërisë është : "ALRWAAD" Sh.P.K.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet I njejt emërtim, me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emertim një shënim I cili ka të bëjë me transferimin.

## SELIA E SHOQËRISË

### "NENI 3

1. Shoqëria tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, a selië qendrore në territorin e republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranës, Tirane. Njesia Bashkiake Nr.10. Rruga Bogdanev. Vila nr. 22. Nr 2.

.Shoqëria mund ë krijojë qendra sekondare, filial, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

2. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë . Njësia strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjilacionin shqipëtar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.

### KOHËZGJATJA

#### NENI 4

1. Shoqëria tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë dhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

#### NENI 5

Objekti i shoqërisë "ALRWAAD" Sh.P.K do të jetë:

- Tregti e filtrave të ujit dhe prodhimin e ushqimit për bagëtinë. import- eksport me shumicë.

### TË DREJTAT E SHOQËRISË

#### NENI 6

Shoqëria tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industrial që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 lekë (një qind mijë lekë), i cili është tërësisht capital financiar. Kapitali themeltar është kuotë me vlerë nominale 100.000 lekë.

Kapitali themeltar zotërohet nga:

**1. HAMADA HELMY ABDELBADIE ABDELHAMID**, zotërues i 1 (një) kuote apo 100% të kapitalit të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji. Kapitali fillestar nuk është paguar.

### NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të vecanta të financimit për zhvillimin ekonomik tregtar.

### NENI 9

1. Përbërja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i cdo fondi të vecantë përcaktohen nga ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.

2. Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe ën përgjithësi cdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ën mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

### NENI 10

1. Shoqëria tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, është pronaree pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emër të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera material në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.

Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

### NENI 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.

2. Aktiviteti financiar i shoqërisë do të mbyllet me 31 Dhjetor të cdo viti dhe bilanci do të miratohet Brenda tre muajve të vitit në vazhdim.

3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me Vendim të ortakëve të saj.

### NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjesh pasurore midis bashkëshortëve dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.



### NENI 13

Transferimi I pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që aim und të ketë pasuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

### NENI 14

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakëve.

### NENI 15

Zmadhimi I kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo I zvogëlimi I tij bëhet më Vendimin e Ortakëve të shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti I firmësose kontabli I miratuar.

## KREU I DYTË

### ORTAKËRIA

### NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregtare "ALRWAAD" Sh.P.K, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë. Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve.

### NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të indormohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi I shoqërisë
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

## KREU I TRETË

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administrator I emëruar I ka të gjitha kompetencat për të

vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të vecanta që ligji I jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Adminstratori i Shoqërise është:

## Z. HAMADA HELMY ABDELBADIE ABDELHAMID.

të cilët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.

2. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, I cili emërohet me vendim të Ortakëve.

## ASAMBLEJA

### NENI 19

1. Asambleja e ortakëve është organi më I lartë vendimmarrës I shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Cdo klauzolë e kundër është e pavlefshme në këtë rast.

### NENI 20

Asambleja e ortakëve ka të drejtë:

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj;
9. Cdo vendim tjetër që I njihet nga ligji, Akti I Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

## TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që I nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni I punës Republikës së Shqipërisë!

4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë Brenda kufinjve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punojësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblenë e ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për cdo vit pasuesdhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

#### NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me economist të licensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me regjistrimin në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron akvitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.  
Mos marrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor.

#### FORCAT MADHORE

#### NENI 25

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme.

Bgjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftësi të plotësojnë detyrimet e tij për arsye të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

## SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

### NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çdarëdo shkak.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë;

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negative (humbje)

-Me vendim të gjykatës ose për arsye të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shumë likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat.

Në rastin e likujdimit emërtimi I shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi "Shoqëri në likujdim".

Mbasi bëhet njoftimi I mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria crregjistrohet nga regjistri tregtar I Qendrës kombëtare të Biznesit.

### BAZAT LIGJORE

### NENI 27

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë".

### RUAJTJA E SEKRETIT

### NENI 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhënat dhe njoftime secrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen secrete.

### DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### NENI 30

Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### NENI 31

1. Ky Statut përpilohet në 5 (pesë) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore.
2. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë;
3. Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ortaku I vetëm

**HAMADA HELMY ABDELBADIE ABDELHAMID**

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized, overlapping letters and a horizontal line extending to the right.